



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 277 / Prot
2

Tiranë më 28.2 .2022

VENDIM

Nr. 8 , Datë 21.02 .2022

“PËR MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E DYTA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË NË FUSHËN E DREJTËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në RSH” në nenin 3 pika 3 gërma ç), nenin 38 pikat 1 dhe 3, neni 49 pika 2 gërma c); VKM - në nr. 288., datë 21.5.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, Statutin e Universitetit të Tiranës neni 55; Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, nr. 02 datë 31.01.2022; Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.02.2022,

VENDOSI

1. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në një program të dytë studimi në vitin e parë të ciklit të parë Bachelor, dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë për vitin akademik 2021-2022, do të jetë sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtuj vendimi
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

